

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetëm gjykuese, Sadije Selmani, me sekretaren juridike Luljeta Luboteni, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II nr. 15 të datës 22.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit dhe të dëmtuarit E. Zh., me datë 17.11.2016, publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. S. nga i ati N., e ëma Sh. e vajzërisë R., i lindur me 30.08.1991 në Gjakovë, ku edhe jeton në rrugën "T." p.nr, ka të kryer shkollën e mesme, rrobaqepës, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal .

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 02.09.2015, rreth orës 04:30 minuta, në Prizren, në drejtimin Prizren – Gjakovë, saktësisht në afërsi të Seperacionit " " në Landovicë, duke shkelë ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacion rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtareve të markës "Mercedes 19 E", ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjetin dhe me të arritur para kthesës në të majtë të lëvizjes përfundon i përmbysur, me ç'rast përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson bashkudhëtari i tij – i dëmtuari E. Zh., lëndime këto më për së afërmi të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, dr. N. H. të dhënë me datën 09.11.2015.

Me këto veprime ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 4, 6, 7,17, 41, 42, 46, 73 dhe nenin 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KP-së, të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumë prej 200 € (dyqindë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burgim, përkatësisht 10 (dhjetë) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizën e komunikacionit rrugor shumë prej 40.88€, për ekspertizën mjeko-ligjore shumë

prej 20 € si dhe paushallin gjyqësor shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP/II nr. [REDACTED]/15 të datës 22.01.2016, kundër të akuzuarit D. [REDACTED] S. [REDACTED] nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KP-së.

I akuzuari D. [REDACTED] S. [REDACTED], ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit dhe njëherit shpreh keqardhje për rastin që ka ndodhur duke theksuar se të dëmtuarin e ka shokë dhe shoqrohen mes veti.

Në bazë të pranimit vullnetarë të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave tjera, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D. [REDACTED] S. [REDACTED], me datë 02.09.2015, rreth orës 04:30 minuta, në Prizren, në drejtimin Prizren – Gjakovë, saktësisht në afërsi të Seperacionit "[REDACTED]" në Landovicë, duke shkelë ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të Ligjit për sigurinë në komunikacion rrugor dhe nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, aq sa vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e udhëtareve të markës "Mercedes 19 E", ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit [REDACTED], kur arrin në vendin kritik, shpejtësinë e lëvizjes së automjetit nuk ia ka përshtatur kushteve dhe rrethanave në rrugë, nga pakujdesia humb kontrollin mbi automjetin dhe me të arritur para kthesës në të majtë të lëvizjes përfundon i përmbysur, me ç'rast përveç dëmeve materiale, lëndime të lehta trupore pëson bashkudhëtari i tij – i dëmtuari E. [REDACTED] Zh. [REDACTED], lëndime këto më për së afërmi të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, dr. N. [REDACTED] H. [REDACTED] të dhënë me datën 09.11.2015.

Gjykata, gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e të akuzuarit duke u mbështetur edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë mendimin e ekspertit mjeko – ligjor Dr. N. [REDACTED] H. [REDACTED] të dt. 09.11.2015, në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Ing. L. [REDACTED] P. [REDACTED] të datës 30.09.2015, raportit të njësisë së trafikut të Stacionit Policor në Prizren, me nr. 2015-GR- [REDACTED] të datës 02.09.2015 si dhe nga foto dokumentacioni dhe nga shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare, pas shqimit të shkresave të lëndës dhe provave materiale në të cilat është mbështetur aktakuza e prokurorisë së shtetit, nuk gjeti se egziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe për këtë e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, raportet shoqërore që kanë me të dëmtuarin, asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, qëndrimi korrekt ndaj gjykatës, andaj gjykata i shqiptoi dënim me gjobë si në shqiptim të aktgjykimit, sepse konsideron se këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i tij, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij

dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u muar në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.138/16 të datës 17.11.2016

**Sekretarja juridike
Luljeta Luboteni**



**Gjyqtarja e vetme gjykuese
Sadije Selmani**



UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.